

PROF. QAZIM TURDIU

(1917 – 1989)

MINGA A.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Matematikës

Kremtimi i 50-vjetorit të themelimit të Universitetit të Tiranës na dha rastin të përkujtojmë me respektin, nderimin dhe mirënjohjen më të ndjerë figura të shquara që vunë njohuritë, talentin dhe, mbi të gjitha, punën plot pasion, në shërbim të misionit fisnik për të cilin u ngrit ky institucion. Ata i dhanë atij emër të mirë e prestigj për ta përligjur cilësimin ‘tempull i dijes’, dhe për t’u renditur me dinjitetin e duhur krahas institucioneve të ngjashme. Pa dyshim, ndër këto figura përfshihet edhe Prof. Qazim Turdiu.



Jeta dhe veprimtaria e Prof. Turdiut shtrihet në një hark kohor interesant.

Për një çerek shekulli, nga 1957-a deri më 1982, ajo ishte e lidhur me Universitetin, pra bash atëherë kur punohej intensivisht për ta vënë atë mbi themele të shëndosha, për ta bërë të aftë të ecte me hapin e kohës, dhe për ta shndërruar në një nyje me ndikim të fuqishëm në zhvillimin e vendit. Mirëpo Universiteti ka edhe parahistorinë e tij, pra ndodhitë e asaj periudhe që e bënë të mundur e të domosdoshëm aktin e themelimit më 1957. Edhe me këtë periudhë, të themi përgatitore, është e pleksur një copëz e jetës së Prof. Turdiut, në të cilën kontributi i tij ka qenë i vyer e me peshë. Janë vërtet çaste të rëndësishme të rrugës së përparimit arsimor të vendit, ndriçimi i të cilave në sfondin e kuadrit dhe perspektivës historike, kërkon vëmendjen e studiuesve.

Rruga jetësore e çdo njeriu kushtëzohet nga rrethanat e përgjithshme të kohës, por edhe nga mjedisi i veçantë familjar në të cilin ai formohet dhe edukohet sipas një kodi të caktuar aksiologjik, pra një hierarkie vlerash që duhen respektuar. Natyrisht, këto janë mjaft përcaktuese, por në një masë jo të vogël, njeriu është arkitekt i jetës së vet.

Caku ku zë fill jeta e ndërgjegjshme e Qazim Turdiut u takon viteve '20-të, kur shteti shqiptar po hynte në rrugën e konsolidimit. Tirana, që sa ishte bërë kryeqytet, po rrekej të shndërrohej nga një vendbanim relativisht i vogël dhe i përgjumur në një qytet që ta meritonte kthimin në qendër të jetës së vendit. Mendimi i përparuar i inteligjencies së pakët në numër, në kërkim të modeleve që duheshin ndjekur për të siguruar progres të mirëfilltë, nuk gabonte në orientimet e veta strategjike: flakjen tej të mendësive të vjetra e të mykura, të parapëlqimeve nostalgjike të një shtrese që po i perëndonte ylli, të plogëtisë orientale të kultivuar nën sundimin e gjatë osman. Po ndihej gjithnjë e më e mprehtë nevoja e një dinamizmi të ri për të rifituar kohën e humbur, për të zbutur sado pak prapambetjen e madhe të trashëguar. Vendi i priste si ujët e pakët njerëzit e shkolluar në perëndim me shpresën se ata, si bartës të një mendësie të re dhe një kulture të përparuar, do t'i jepnin një shtysë zhvillimit.

Këto fermente filluan të ndiheshin te familjet tiranase. Ato do të ishin nxitëse sidomos për mendjet me *bonsens* e të prirura drejt së mirës. Një njeri me mendje të tillë ishte edhe Mahmud Turdiu, i ati i Qazimit. Ai pati vërtet një karvan pinjollësh, 11 djem e 3 vajza. Të gjithë u arsimuan, ndër ta shtatë prej djemve kryen me sukses shkollën e lartë, dhe u bënë profesionistë të respektuar në fushat që zgjodhën.

Qazim Turdiu shkollimin e mesëm e kreu në gjimnazin e Tiranës, që renditej ndër shkollat e mira të vendit. Në këtë gjimnaz u kultivuan shumë tipare e cilësi të çmuara të tij. Qazimi i përshfaqte ato në të gjitha disiplinat, por ato dilnin në pah më bujshëm në lëndën e matematikës. Arsimtari i talentuar Gjergj Cancoja, që u bë një personalitet ndër më të spikaturit e shkollës shqipe dhe u nderua ndër të parët me titullin e lartë Mësues i Popullit, i cili e jepte këtë lëndë, entuziazmohej nga sukseset e nga pjekuria e Qazimit, dhe thoshte se me nxënës të tillë model do të krenohej çdo shkollë; ky vlerësim i saktë i tij do të ndikonte në vendimin që do të merrte Turdiu.

Pas mbarimit të shkollës së mesme më 1937, meqë Qazimi dhe vëllai i tij Bilali e kishin mbyllur atë me rezultate të shkëlqyera, Qeveria e atëherëshme u ofroi bursa për studime në Akademitë ushtarake italiane. Të dy vëllezërit, duke u këshilluar edhe me të atin, nuk i pranuan, sepse parapëlqenin t'u kushtoheshin profesioneve të tjera. Qazimi kishte zgjedhur mjekësinë, ndërsa Bilali degën e farmacisë, ndjekjen e të cilave do ta përballonin me të hollat që do t'u dërgonte familja. Ndërkohë, kur mbeteshin edhe dy javë nga nisja për në Francë, Qazimi takon rastësisht mësuesin e vet të dashur, të cilit i tregoi për vendimin e marrë. -*Mjekësia është profesion humanitar dhe i nderuar*, - i thotë Cancoja me atë zërin e tij të thellë karakteristik. -*Por unë kam një merak që po ta them. Ti je djalë i talentuar në matematikë. Më duket mëkat të mos e*

shfrytëzosh këtë dhunti; ti i ke të gjitha shanset për t'u bërë matematikan shumë i mirë. Mendohu edhe një herë. Natyrisht, çfarëdo dege të zgjedhësh, ti do t'ia dalësh mbanë me faqe të bardhë. Mua do të më vinte mirë t'i kushtoheshe matematikës. Këshilla e mësuesit, që gëzonte një autoritet të vërtetë, dhe të cilin Qazimi e respektonte fort, mbolli farën e mëdyshjes në shpirtin e djaloshit. Ne nuk e dimë si u zhvillua më tej kjo dramë e vogël, por njohim përfundimin e saj. Qazimi zgjodhi matematikën: fitoi vokacioni mbi opinionin e rrënjësor për përfitimet që sillte një 'profesion i lirë', si mendohesh mjekësia. Familja nuk u bë pengesë dhe kjo është dëshmi e qartë emancipimi, veçanërisht për periudhën që flasim.

Qazim Turdiu u regjistrua në Universitetin e Monpeliësë. Për gati dy shekuj Franca ishte lokomotiva e përparimit matematik; ajo mbetej edhe në shekullin e njëzetë një nga vatrat më të fuqishme të tij, me traditë të admirueshme në formimin e specialistëve të matematikës. Fakultetet e saj matematike, qoftë të metropolit, qoftë të qyteteve më periferike, ishin qendra joshëse për të rinjtë nga bota mbarë që synonin të kryenin shkollimin universitar në këtë fushë.

Në Universitetin e Monpeliësë kishin studiuar edhe vëllezërit Fundo, Kristaqi dhe Petraqi, dhe ata kishin lënë mbresat më të mira me përgatitjen e tyre, këmbënguljen dhe seriozitetin në studim. Qazim Turdiu e përforcoi edhe më tepër këtë opinion pozitiv për shqiptarët në degën e matematikës. Shprehitë e punës matematike, e studimit të thelluar dhe e shfrytëzimit racional të kohës, të fituara që në gjimnaz, i dhanë frytet e dëshiruara; ai përparonte me hapa të shpejtë e të sigurt në përvetësimin e një kulture solide matematike. Dhuntitë e Qazimit, falë vënies në lëvizje dhe stërvitjes së pandërprerë të mekanizmave të punës së mirëfilltë intelektuale dhe krijuese, patën hapësirën e duhur për t'u shpalosur. Turdiu u dallua ndër bashkëstudentët dhe rezultatet që arrinte e renditnin në klasifikim me më të mirët e kursit në të gjitha vitet e shkollimit. Përfundimi i shkëlqyer bëri që të përzgjidhesh ndër kandidatët e mundshëm për çmim; si më i merituari ndër të tjerët, Universiteti do t'i jepte atij çmimin Templier, madje duke bërë një përjashtim në këtë rast, sepse, si rregull, me të nderoheshin vetëm studentë francezë.

Në përfundim të studimeve Turdiut i ofrohet mundësia për të punuar si asistent, e për të bërë karrierë universitare në institucionin ku u formua. Tundimi për të punuar në një qendër të tillë, si për gjithkënd, ishte i madh edhe për të riun Turdiu. Por për të ishte më e fuqishme ndjenja e detyrimit ndaj familjes, që duke sakrifikuar kishte mbajtur barrën e tërë shpenzimeve të shkollimit të tij. Nuk ishte pa peshë edhe ndjenja e mallit dhe e dashurisë për vendin dhe vetëdija se për Shqipërinë puna e tij, në një rrafsh më të gjerë, mbase do të ishte më e dobishme, çka urtësia popullore e ka sintetizuar në

thënien 'guri i rëndë në vend të vet'. Këto ishin arsytet që Turdiu nuk e pranoi ofertën dhe u kthye në atdhe.

Në vitin 1941 emërohet në Gjimnazin e Tiranës. Shumë shpejt dallohet si një mësues me personalitet, i përgatitur, por edhe me aftësi të veçanta për t'ua përcjellë nxënësve sa më mirë njohuritë në klasë. I rreptë, së pari ndaj vetes; ai e quante të dëmshme dhe joedukuese të bënte lëshime në kërkesat e drejta ndaj nxënësve. Aq më tepër kur kërkohej ndonjë 'lëshim përzgjedhës' e mbyllje sysh me adresë të qartë. Ndodhi që ndaj Turdiut u bë një kërkesë e tillë, u ushtrua edhe presion i hapur, se ishte fjala për 'të ndihmuar' të birin e një gjerarku të njohur fashist. Qazimi nuk u thye: djaloshi mori vlerësimin e merituar. Qëndrimi i Turdiut nuk ishte politik, jo; ai ishte në pajtim me kodin e korrektesës profesionale, të cilit ai do t'i përmbahej me fanatizëm gjatë gjithë karrierës së tij si pedagog. Reagimi nuk vonoi; Qazim Turdiu transferohet në Gjimnazin e Shkodrës, pa u mbushur një vit si kishte filluar punën.

Lëndimin në shpirt nga kjo masë e padrejtë e mbajti si një përjetim të brendshëm. Ai nuk do ia lejonte vetes të shfaqte ndonjë simptomë të tij në punën si mësues. Nxënësit që patën fatin të bënin mësim me të e ndjenë menjëherë ndryshimin që sillte Turdiu në klasë. Dhe, si dihet, ata janë mjeti me reagimin më të shpejtë e më të saktë në vlerësimin e mësuesit. -*Filluam ta perceptonim ndryshe lëndën e matematikës*, – kujton njëri syresh, Vladimir Misja. -*Nuk na dukej më matematika si një tog rregullash që duheshin mbajtur mend, si një renditje njohurish të mërzitshme e alternuar me ushtrime të bezdishme. Hap pas hapi profesor Turdiu, me elegancën e paraqitjes së materialit, me shpjegimin e qartë e theksimet e nevojshme logjike po na zbulonte bukurinë e fshehur të matematikës.* Për aq kohë sa ndenji në Shkodër, Turdiu krijoi një emër të mirë, për përgatitjen e tij, por veçanërisht për aftësinë didaktike dhe taktin pedagogjik.

Thuajse pak kohë pas Çlirimit transferohet në gjimnazin e Tiranës, që kishte një trupë pedagogjike të përzgjedhur. Tanimë ai ishte një figurë e njohur, prandaj mendimi i tij kërkohej dhe dëgjohej për programet e matematikës shkollore dhe për çështje të mësimdhënies së saj, jo vetëm brenda shkollës ku punonte, por edhe në rang kombëtar. Horizonti i gjerë, kultura matematike dhe aftësitë e tij profesionale e kishin renditur ndër ekspertët më të mirë të vendit për çështjet e lidhura me matematikën, si një ndër lëndët kryesore shkollore. Është kjo arsyeja që kur u vendos të krijohet Instituti Pedagogjik dy-vjeçar, për t'iu përgjigjur nevojave tepër të ngutshme për mësues të përgatitur, çka diktohej nga zgjerimi i ndjeshëm i arsimit të mesëm, Qazim Turdiu ishte ndër ata që do të angazhoheshin në këtë institucion të parë të arsimit të lartë në vend.

Dhjetori i 1946-s, kur Instituti hapi dyert e veta, shënon fillimin e një etape tjetër në karrierën pedagogjike-shkencore të Turdiut. Ai, bashkë me Prof. Sotir Kuneshkën dhe Petraq Fundon, ndanë barrën dhe përgjegjësinë për të ngritur degën e matematikës dhe të fizikës në këtë Institut, që, natyrisht, ishte një nga më të rëndësishmet e tij. Prof. Kuneshka, që kishte edhe detyra të karakterit drejtues administrativ, do të mbulonte disiplina fizike, Petraq Fundoja parapëlqente vetëm disiplina matematike, ndërsa Q. Turdiut iu desh të jepte në auditor edhe disiplina matematike, por edhe fizikë kur lindte nevoja. Pavarësisht se ai ishte më i prirë ndaj matematikës, edhe fizikën e zhvillonte me po atë përkujdesje e me të njëjtin nivel si matematikën.

Ngritja e Institutit qe një akt i guximshëm. Në qoftë se Instituti e formoi relativisht shpejt fizionominë e vet dhe e kreu me dinjitet shkencor misionin që i ishte besuar, kjo ndodhi se në të u angazhuan persona që i takonin elitës intelektuale të vendit në atë periudhë. Dega e matematikë–fizikës qe ndër më të dalluarat. Puna që bëri treshja e përmendur për hartimin e planeve dhe programeve mësimore, për përzgjedhjen e brendisë së lëndëve dhe të mënyrave të trajtimit të saj ka qenë vërtet e madhe, aq më tepër kur nuk kishte asnjë traditë dhe përvojë në këtë fushë. E lehtësonte disi këtë punë, fakti që të tre, Kuneshka, Turdiu dhe Fundoja, ishin përgatitur në Francë, madje dy të fundit në të njëjtin universitet, në Monpelie. Prandaj, si ishte e kuptueshme, mendimet dhe idetë e tyre hynin në rezonancë fuqizuese; pajtimi në qendrim ishte, në fund të fundit, një konstante e diskutimeve të gjalla e të vazhdueshme. Pak a shumë u përshtat modeli francez, pra ai i një shkolle perëndimore me traditë e mjaft të përparuar. Themi u përshtat, sepse Franca nuk ofronte model të gatshëm në këtë fushë. Ish Bashkimi Sovjetik kishte institucione të këtij tipi dhe, ndoshta planet mësimore të tyre kanë pasur ndikim të tërthortë në përcaktimin e nomenklaturës së lëndëve, por ky ndikim filloi të ndihej pas vitit 1948. Kultura matematike që jepej në Institut ishte përvijuar në një masë të madhe sipas përmbajtjes së dy viteve të para përgatitore universitare franceze, që garantonin bazën matematike e fizike të një formimi më të specializuar.

Për grupin e lëndëve të së ashtuquajturës matematikë elementare, Turdiu ka një meritë kryesore. Natyrisht, nuk liheshin pas dore edhe njehsimi diferencial e integral, pra analiza klasike, me ndonjë plotësim të nevojshëm, por theksi vihej tek të parat. Një karakteristikë e shkollës franceze, e cila u ruajt, ishte vëmendja e posaçme që u kushtohej ushtrimeve dhe problemeve. Kuneshka, Turdiu dhe Fundoja ishin të bindur se përzgjedhja e kujdesshme e ‘problematekës’, nëse mund të shprehemi kështu, ishte mjete më efektiv dhe më racional për një përvetësim të mirëfilltë të njohurive. Visari i ushtrimeve dhe i problemeve që zgjodhën ata ishte një pasuri, që shërbeu për atë kohë, por

edhe mjaft më gjatë. Të diplomuarit e Institutit Pedagogjik, ndonëse të pakët në numër, të shpërndarë në të gjithë vendin, sollën një frymë gjallëruese sidomos në arsimin e mesëm dhe ndikuan në rritjen e nivelit të mësimdhënies së matematikës. Nga ky kontingjent, shumica dërrmuese u bënë mësues të shquar e drejtues shkollash e u nderuan me tituj për punën e tyre cilësore e të përkushtuar.

Instituti Pedagogjik dyvjeçar, si provë e suksesshme në fushën e arsimit të lartë, nxiti të ecej më përpara e të shpejtoheshin ritmet e krijimit të Instituteve me cikël të plotë studimesh, të cilat çelën dyert e tyre në nëntor të 1951–shit. Në Institutin e Lartë Pedagogjik, që ishte njëri ndër ta, u krijua për herë të parë Katedra e Matematikës dhe e Fizikës, e cila mbulonte disiplinat përkatëse në të dy institutet (2- dhe 4-vjeçar), tanimë pjesë të një strukture. Në këtë katedër një ndër figurat kryesore ishte Prof. Q. Turdiu. Katedra ishte plotësuar tanimë me kuadro të shkolluara në vendet lindore, por edhe në Institutin tonë 2-vjeçar. Efektivi i ri i saj, pas sprovës dhe seleksionimit të natyrshëm, u stabilizua shumë shpejt. Të rinjtë, për fat, me formim të qëndrueshëm, me kulturë të përgjithshme e speciale, por, mbi të gjitha, me mendje të hapur dhe largpamësi, sillnin përvoja të reja nga shkollat që kishin kryer, të cilat kishin një vend elitar në arsimin universitar në shkallë ndërkombëtare. Jo vetëm nuk pati ‘luftë brezash’ në katedër, por, përkundrazi, ndodhi një amalgamim i mirë i prurjeve interesante me origjinë nga shtete të ndryshme. Tradita e krijuar në Institutin 2-vjeçar ishte pozitive, përvoja e fituar nuk mund të shpërfilllej, sidomos përsa i takon bllokut të disiplinave që përbënin të ashtuquajturën matematikë elementare. Prof. Turdiu, aktori kryesor në hartimin dhe konsolidimin e programeve të tyre, si titullar i padiskutueshëm, u caktua të mbulonte leksionet e tyre në të dy institutet. Ai mori përsipër edhe lëndët e Metodikës së Matematikës dhe të Astronomisë.

Brezit tonë, që studionte në Institut në ato vite, i bënte përshtypje që e shihte aq shpesh Turdiun në bibliotekë. Biblioteka e Institutit po pasurohej sidomos me tekste në gjuhën ruse. Me këmbënguljen e tij karakteristike, Turdiu iu vu studimit të saj dhe e përvetësoi në atë shkallë sa mund të shfrytëzonte literaturën matematike. Ai dinte të qëmtonte në të informacionin e ri dhe trajtime interesante; në këtë mënyrë, përditësonte dhe ripërtërinte vazhdimisht leksionet e tij.

Po ta dinte çfarë ngarkese mësimore përballonte atëherë Prof. Turdiu në auditor, çdo njeri me një minimum eksperience në këtë lloj veprimtarie, do ta përfytyronte qartë çfarë pune e mundi i është dashur të investonte. Mirëpo, do të habitej vërtet po të mësonte se kjo ishte vetëm një pjesë e ngarkesës së profesorit. Praktikisht për gati 15 vjet, duke filluar nga 1945-a e deri në fund

të viteve '50-të, Turdiu ka mbajtur një barrë tejet të madhe për kualifikimin e mësuesve të matematikës. Nevojat e rritura eksponencialisht për të mbuluar lëndën e matematikës në shkollat e vjetra që po zgjeroheshin, por sidomos në shkollat e reja që po hapeshin, bënë që me këtë detyrë të ngarkoheshin edhe mësues 'të sajuar', jo vetëm pa arsimin përkatës, por edhe pa shkollim të mesmë të përfunduar. Problem tepër i mprehtë ishte kualifikimi i tyre, në atë masë të pranueshme që mund të sigurohej. Prof. Turdiu merr pjesë intensivisht në këtë proces. Ai drejtonte seminare kualifikimi, kurse verore, është hartuesi i disa 'letrave metodike' që dikasteri dërgonte nëpër shkolla në ndihmë të mësuesve për zberthimin e çështjeve delikate të programeve, konsultonte në kabinetin pedagogjik gati përditë mësues të Tiranës për vështirësi që hasnin; merrej me hartimin e teksteve të para të përshtatura etj. Kjo veprimtari i siguroi një njohje vërtet të thellë të shkollës sonë e të problemeve të saj dhe i ofroi një material tepër të begatë; këtë ai e shfytëzoi në punën kërkimore në fushën e didaktikës, për të cilën nisi të interesohet në këtë periudhë, dhe së cilës iu përkushtua duke nxjerrë duarsh punime me vlerë.

Shkollën Turdiu e konsideronte laboratorin e mirëfilltë, ku vinte në zbatim dhe kontrollonte rreptësisht idetë didaktike. Ai e çmonte praktikën pedagogjike të studentëve si një rast që duhej shfrytëzuar optimalisht edhe në këtë aspekt. Ne që patëm fatin ta zhvillonim praktikën nën drejtimin e tij, ndonëse kanë kaluar më shumë se 52 vjet nga ajo kohë, ruajmë mbresa të pashlyeshme. Prof.

Turdiu ulej me orë me secilin prej nesh për t'i kontrolluar përgatitjen për orën e mësimit në çdo hollësi të saj. Me përvojën që kish, profesori na zbulonte shumë sekrete të profesionit; provokonte situata kritike dhe, pasi dëgjonte reagimin tonë; na udhëzonte si duheshin gjetur rrugëdaljet më të mira të shoqëruara me argumentime origjinale didaktike. Të papërsëritshme ishin analizat e tij. Shpesh krijonte një atmosferë të tillë që vërejtje kritike të bëheshin shkas për meditime më të thelluara, sepse dinte të nxiste me pyetje të mençura minidebate interesante. Por profesori nuk nguronte të vinte në dukje me theks të veçantë edhe kur mësimi pat shkuar mirë, por sidomos kur zbulonte diçka që i linte mbresë. Ai dinte ta çmonte të mirën dhe gjetjeve, shpesh spontane, ua zberthente aq bukur vlerat që ngërthenin, sa na befasonte.

Si ndodh rëndom, tek zhvillonim mësimit e para përpqeshim të imitonim mësuesit që na pëlqenin. Nuk do ta harrojmë një këshillë që na e dha me shumë takt: *-Dëgjoni, çuna! Gjinnazi 'Qemal Stafa' ka mësues shumë të mirë, Zef Zymerin, Pëllumb Gjebrenë, Orhan Pojanin etj., që si rrallëkush e kryejnë detyrën e tyre. Përfitoni nga kjo përvojë që shpalolet para jush, por jini vetëvetja. Mësuesit e mirë janë modele nga të cilët duhet marrë shembull, por nuk duhen imituar verbërisht, Çdo njeri ka personalitetin, karakterin dhe temperamentin e vet. Tipit psikologjik të Orhan Pojanit, për shembull, nuk do*

t'i shkonin batutat hokatare e sjellja e gjallë e Pëllumb Gjebresë, ashtu si Pëllumbi do të ngjallte ilaritet, po të reagonte me seriozitetin e Orhanit, që nxënësvë u duket fare i natyrshëm. Prandaj, mblidhni nektar nga shumë lule, por bëni mjaltin tuaj.

Tradita e praktikës pedagogjike, e krijuar nga profesorët tanë, Kuneshka dhe Turdiu, duhet çuar më tej, dhe nuk duhet zbehur. Në vitet '50-të ndodhte e kundërta me atë që vihet re sot që shkollat duket sikur e kanë bezdi kur presin grupe studentësh praktikantë. Në atë kohë, shkolla sikur gjallërohej kur vinin studentët; e tërë trupa mobilizohej, sepse edhe mësuesit, ashtu si studentët, donin të bënin figurë të mirë në sy të mjeshtërve të paarrtshëm të mësimdhënies si Turdiu e Kuneshka.

Më 1957 u themelua Universiteti i Tiranës. Një synim i ri thelbësor që përvijoi kjo ngjarje ishte objektivi për ta shndërruar Katedrën e Matematikës në katedër të vërtetë universitare, e cila të ndërthurte harmonishëm veprimtarinë mësimore me kërkimin shkencor. Në strategjinë e ndjekur në ato vite, përparësi mernte kualifikimi shkencor i kuadrit dhe institucionalizimi i formave standarde të sprovuara në botë, si seminarët shkencore, kryerja e aspiranturës; në përshtatje me kushtet tona, edhe ndjekja e kurseve të rregullta speciale për zgjerimin e spektrit të kulturës matematike në lëndë të reja me perspektivë të qartë zhvillimi. K. Fundoja dhe Q. Turdiu ishin më të moshuarit në katedër, por edhe ata u përfshinë aktivisht në këtë proces, njëlloj si më të rinjtë.

Në vitin 1958-59, Turdiu u regjistrua për të kryer aspiranturën pa shkëputje nga puna në Universitetin e Moskës. Vështirësitë për të rriteshin edhe për një rrethanë tjetër. Turdiu e kishte kryer shkollën e lartë rreth 20 vjet më parë, dhe gjatë kësaj periudhe matematika kishte përjetuar një zhvillim tejet të vrullshëm; shkurt, atij i duhej të bënte një sforcim shtesë jo të vogël për të arritur në bazën normale të nisjes. Me vullnetin që e karakterizonte dhe planifikimin metodik të hapave në studim, që ishte kthyer në natyrë të dytë të tij, ai kapi ritmet normale të aspiranturës, duke garantuar shanse për sukses në shlyerjen e detyrimeve të pritshme të nevojshme. Ndërkohë, në vitin 1960, Komisioni i Atestimit, duke pasur parasysh veprimtarinë e tij të gjatë pedagogjike-shkencore dhe rezultatet e saj të frytshme, i akordoi gradën e Kandidatit të Shkencave Matematike, që sot është e barazvlefshme me atë të Doktorit të Shkencave. Për pasojë, Turdiu lirohej nga kryerja e aspiranturës, e cila përfundonte me marrjen e kësaj grade. Pavarësisht nga ky fakt, atë kohë që qëndroi në Moskë, Turdiu e shfrytëzoi më së miri për të ripërtërirë kulturën e vet matematike, për të njohur nga afër përvojën në mësimdhënien e disiplinave për të cilat interesohet si dhe jetën intensive shkencore të

Universitetit 'Lomonosov', që, përse i takonte matematikës, renditej ndër më prestigjiozët në botë.

Grada shkencore e akorduar mishëronte faktin që Turdiu në lëmin e didaktikës së matematikës ishte më i miri në vend dhe kishte aftësinë për të trajtuar dhe zgjidhur shkencërisht aspekte të problematikës së saj interesante. Mjaft nga 'letrat metodike' të hartuara prej tij janë miniatura shkencore që shtjellojnë ide origjinale. Në punimin e gjatë, të botuar si libër më vete më 1958 'Lidhja e teorisë me praktikën në mësimin e matematikës', Turdiu i bën një analizë të thelluar shkencore një çështjeje që asikohe diskutohej, por më shumë në rrafshin propagandistik e në nivele përshkruese empirike.

Në vitet '60-të, Turdiu, që kishte një bagazh të pasur përvoja vetjake si metodist, të cilën e ballafaqoi me arritjet bashkëkohore, të qëmtuara me kujdes nga burimet e literaturës që hynin në Shqipëri. Ai hartoi me bashkautor Zef Zymerin një vepër të goditur *Matematika si Shkencë dhe si Lëndë Shkollore*, në dy vëllime; kjo u prit mirë nga opinioni i interesuar. Libri shërbeu jo vetëm si tekst bazë për lëndën e metodikës, por vlejti mjaft edhe për kualifikimin profesional të mësuesve në detyrë. Parimet e përgjithshme të parashtruara në të u konkretizuan në metodika të veçanta si *Metodika e Algjebërës* (hartuar së bashku me Z. Zymerin), *Metodika e Aritmetikës* (me bashkautor Besim Turdiun); këto janë punime të mirëfillta të plota, të cilat mbeten piketa të rëndësishme në rrugën tonë të kërkimeve didaktike.

Në punë e sipër për shqyrtimin e çështjeve didaktike, Turdiut i është dashur të hedhë dritë edhe mbi kuadrin historik, për të ndjekur rrjedhën e evoluimit të ideve apo edhe të ndryshimeve të disa raporteve të caktuara. Ai e ndjeu se këto elemente nuk duheshin parë thjesht si digresione historike që ngjallnin kërshtëri, por si një fill i rëndësishëm, i cili ndihmon të zbulohet më mirë logjika e përparimit. Për këtë arsye, Turdiu e quajti të nevojshme t'i kushtonte një vepër evoluimit të mendimit matematik dhe shkroi librin *Matematika në Shekuj* (botuar më 1972), që është historia e parë, pak a shumë e plotë, e matematikës në gjuhën shqipe.

Zotësia e tij si metodist ka gjetur pasqyrim edhe në një drejtim tjetër të veprimtarisë së Prof. Turdiut, që ka luajtur rol në konsolidimin e matematikës si lëndë mësimore në shkollën tonë dhe në rritjen e nivelit shkencor të trajtimit të saj. Është fjala për tekstet mësimore të ciklit të shkollës së mesme, ku ai ka dhënë një ndihmesë të konsiderueshme. Turdiu është i pari autor pas çlirimit që përshtati në shqip dy tekste të rëndësishme. Më 1951 u botuan *Gjeometria Analitike*, dhe *Algjebra* (me këtë emër etiketoheshin *Elemente të Analizës Matematike*), të cilat ne nxënësit maturanë i pritëm më interes të posaçëm dhe na pëlqeu stili i përkorë e paraqitja e qartë dhe e saktë e përmbajtjes.

Veçanërisht interesante ishte përfshirja në këto libra e problemeve për provimet e maturës në Shqipëri, zberthimi i të cilave na dha dorë të hynim shumë më të përgatitur.

Do të doja të hapja një parantezë të vogël lidhur me këto botime të para. Vite më pas mësova se Prof. Turdiut i ishte ofruar bursë për të ndjekur studimet në Akademinë Ushtarake, por ai nuk kishte pranuar. Unë i them me shaka: *-Mos e kini pishman që refuzuat. Gjithsesi gradën e gjeneralit e fituat ... sepse jua ka dhënë klasa jonë që më 1951*. Kishim disa ditë që kishim marrë në duar tekstin *Gjeometria Analitike*. Prof. Kristaq Fundoja, i cili na jepte lëndën e Matematikës në gjimnazin 'Raqi Qirinxhi' të Korçës, na foli për këtë tekst të ri dhe për vlerat e tij. Na bëri përshtypje që 'e kaloi masën e tij të zakonshme', se ai ishte fjalëpakët, dhe sidomos i kursyer në vlerësime, çka ishte një dëshmi se teksti i kishte pëlqyer. Ai e mbylli paraqitjen me fjalët: *-En général, Turdiu ka shkruar një libër të mirë!* Një bashkënxënës i yni nuk e dëgjoi saktë shprehjen në frëngjisht të Prof. Fundos, të cilën ia zuri veshi kështu: *-Gjeneral Turdiu ka shkruar një libër të mirë!*, dhe shprehu habinë: *-Pse, gjeneral qënka ky Turdiu?! Klasa qeshi dhe në mënyrë të vetëvetishme në kopertinat e librave tanë, atje ku shkruhej 'Adaptue nga Q. Turdiu' ne shtuam edhe gradën e sajuar: 'Adaptue nga gjeneral Q. Turdiu'. Në të vërtetë, nuk gabuam që 'i dhamë' gradën e gjeneralit, pasi Q. Turdiu nuk ishte gjeneral ushtrie me spaleta, por ishte dhe mbeti gjeneral i vërtetë i një armate shumë fisnike – armatës së madhe të mësuesve shqiptarë të matematikës.*

Prof. Turdiu hartoi edhe mjaft tekste të tjera që janë përdorur për një kohë të gjatë në shkollat tona, si *Elemente të Analizës Matematike*, *Aritmetika për Shkollat Pedagogjike*, *Trigonometria Plane* (dy të fundit me bashkautor Z. Zymerin). Ai e çmonte hartimin e teksteve si një detyrë me mjaft përgjegjësi. Megjithëse e njihte shumë mirë gjendjen e shkollës sonë, kërkonte me çdo kusht që në këtë punë të bashkëpunonte me mësues ndër më të përgatiturit, që ballafaqoheshin përditë me nxënësit në klasë, që i njihnin vështirësitë që hasnin ata në matematikë, që kishin sprovuar lloj-lloj mënyrash për t'ua bërë më të rrokshme konceptet, që dinin të përcaktonin saktë masën e përshkallëzimit në nivelin shkencor të shtjellimit. Prof. Turdiu dinte jo vetëm t'i zgjidhte bashkëpunëtorët, por edhe të krijonte një atmosferë të tillë, ku secili t'i shprehte pa druajtje mendimet e tij, dhe të derdhte në mundin e përbashkët frytën më të sublimuar racionalisht të përvojës së vet të çmuar.

Titulli Mësues i Merituar që iu akordua më 1965 ishte një njohje e ndihmesës së rëndësishme të Q. Turdiut për arsimin kombëtar, ndërsa titulli shkencor Profesor, që iu dha më 1972, mishëronte me të drejtë arritjet pozitive të një

veprimtarie intensive kërkimore dhe botuese në fushën e didaktikës së matematikës.

Në fillim të viteve 1960, Prof. Q. Turdiu, çeli një faqe të re të karrierës së tij pedagogjike. Duke e ditur reputacionin që gëzonte si pedagog, drejtues dhe pedagogë të Fakultetit të Inxhinierisë (konkretisht Z. Këlliçi, T. Haxhiymeri, B. Daja etj.) kishin shprehur dëshirën që ai të angazhohej në këtë Fakultet me shpresën se lënda e matematikës do të bëhej më joshëse për studentët dhe do të përmirësoheshin rezultatet e tyre në provime. Pasi morën pëlqimin e tij dhe miratimin e Katedrës, Prof. Turdiu ngarkesën kryesore do ta kishte në degët inxhinierike, ndërsa në degën e matematikës do të vazhdonte të mbante leksionet e metodikës. Me të njëjtin përkushtim dhe seriozitet karakteristik për të, ai shpaloste para studentëve në auditorët e inxhinierisë njohuritë matematike, duke e vënë theksin në zbulimin e thelbit të koncepteve bazë dhe në universalitetin e tyre, çka u jep atë fuqi zbatimi në fusha teknike nga më të ndryshmet. Studentët e ndienin se Prof. Turdiu bënte çmos për t'ua bërë matematikën të qartë, të kuptueshme dhe për t'i bindur se përvetësimi i saj do t'u jepte në dorë një mjet tejet efikas e të domosdoshëm në profesionin e tyre të ardhshëm. Me qëndrimin e tij korrekt, kërkesën në provime dhe vlerësimet e drejta ndikonte në përkushtimin e tyre më të madh në studim dhe fshirjen nga mendja të gjetjes së rrugëve të pandershme për të siguruar ndonjë lëshim; rrugë të tilla ishin pa krye, dhe nuk të çonin kurrë deri te Turdiu, për të cilin detyra e pedagogut kishte petkun e panjollësuar të shenjtërisë.

Një njeri me përvojë si Prof. Turdiu, i ndjeshëm ndaj reagimit të auditorit, qëmtues i kujdesshëm i të dhënave që vijnë nga burime të ndryshme dhe vlerësues i saktë i vërejtjeve, u bë pjesëmarrës ndër më aktivët dhe më autoritarët në diskutimin e herëpashershëm të programeve për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të kohës. Këshillat e tij për përmirësime, të matura e të argumentuara drejt, mirëpritëshin nga kolegët më të rinj. Prandaj Prof. Turdiu u bë një figurë qendrore dhe shumë e respektuar e Katedrës së Matematikës të Përgjithshme.

Kur po mbyllte vitin e dyzetë të një karriere të suksesshme pedagogjike e shkencore, plot përkushtim, që e kishte vendosur emrin e tij në yjësinë e figurave të shkollës shqipe dhe të arsimit matematik në veçanti, Prof. Turdiu përjetoj një dramë të vërtetë. Do të dëshiroja të përmendja këtu ndonjë element që mendoj se ndihmon për të ndriçuar disa raporte. Prof. Turdiu, megjithëse punëtor, i palodhur dhe me kontribute të rëndësishme, nuk ka qenë dhe nuk mund të bëhej i ledhatuar i regjimit, i cili rrëmonte në biografi, dhe kur gjente 'njolla' sipas këndvështrimit të tij, qoftë edhe në rrethin e gjerë familjar, mbetej dyshues ndaj këtyre 'të shënjuarve'. Megjithkëtë, për të qenë

më të saktë, regjimi i atëhershëm nuk e ka diskriminuar Q. Turdiun as në raport me shtresën e profesionistëve të paraqirimit, as në raport me të tjerët. Mbaje jo me entuziazëm, por nderet dhe vlerësimet që atij i takonin, plotësisht të merituar, ia ka dhënë, pa e ndarë nga kolegët. Iu dha titulli Docent, që më 1957, grada e Kandidatit të Shkencave, më 1960; u bë Mësues i Merituar, më 1965; iu dha titulli Profesor, më 1972; u dekorua me urdhra dhe medalje etj.

Kolektivi ynë i matematikës ishte me fat që kishte në gjirin e tij një profesionist të zotin, me përvojë të madhe dhe me pjekuri gjykimi si Prof. Turdiu; por edhe ai kishte fatin të punonte me kolegë ndaj të cilëve indoktrinimi vepronte me shumë më pak efekt. Në këtë kolektiv veprimtaria e kujtdo është çmuar sipas meritave dhe nuk është parë asnjëherë përmes lenteve aberrative të biografive. Turdiu e ndiente sigurinë për të punuar i qetë dhe ndershmerisht, madje e kishte provuar se atij i delnin në krah dhe e mbronin pa mëdyshje kur 'zelltarë vigjilentë', jashtë këtij grupi (dhe të tillë natyrisht ka pasur), janë rrekur të hedhin hije mbi të e ta godisnin. Natyrisht, Prof. Turdiu ishte i kujdesshëm dhe sjelljet e qendrimet e tij mund të karakterizohen si politikisht korrekte në atë kuptim që anglezët i japin togfjalëshit '*politically correct*'. Kjo nuk e ftohu asnjëherë zellin e tij për punë, sepse ai kishte bindjen se veprimtaria e tij ishte në të mirë të vendit, i jepte dorë zhvillimit arsimor të popullit të cilit i përkiste, shkonte në kahen e progresit. Këtë kredo e ndoqi tërë jetën pa lëkundje, pa e kursyer veten, pa u stepur para barrës së detyrave që i ngarkonin.

Në qendrimin e Turdiut asgjë nuk kishte ndryshuar. Ndërroi befaz qëndrimi ndaj tij dhe familjes pas ngjarjes së njohur të vitit 1981. Çdo njeri normal do të përjetonte ashtu si Prof. Turdiu dhimbjen e thekshme të një goditjeje të pamerituar, e cila shkoi duke u shkallëzuar rëndshëm. Me keqardhje të thellë i përcollën këto ndodhi edhe ata që e njihnin Profesorin, dhe sidomos ata që kishin punuar me të. Megjithatë, e them me bindje se respekti mbeti i pacënuar. Në kolektivin e matematikës nuk iu bë asnjë jehonë refreneve bajate të 'solidarizimit me masat e drejta të Partisë' ndaj tij. Me plagën e pambyllur në shpirt ai i jetoi vitet që erdhën më pas. Natyrisht, atë ia lehtësonin dashuria dhe ngrohtësia e bashkëshortes, Hasimes së fisme e të zgjuar, e fëmijëve, por edhe e tërë rrethit familjar që e kishte simbolin dhe emblemën e fisit, këshilluesin e urtë për çdo problem. Nuk i munguan as kujdesjet dhe solidariteti i miqve dhe dashamirëve që nuk iu ndanë në ditët e vështira.

Në këtë muzg të jetës, mes pezmit, hidhërimeve, zhgënjimeve e pa një dritëz gëzimi. Autoritetet e kohës korrigjuan diçka në masat e tepruara ekstreme ndaj tij. Pas disa vjetësh të humbura pa kthim, iu ridha e drejta e studimit fëmijëve,

nipave e mbesave, që u ishte hequr dhunshëm në 1982, ndonëse ishin të shkëlqyer në mësim.

Prof. Qazim Turdiu i mbylli sytë më 9 prill 1989. Më vjen mirë të theksoj se thujse deri në ditët e fundit nuk i hoqi nga dora librat e matematikës, të cilat i pati si balsam për lëndimin e rëndë shpirtëror.

Pas ndryshimeve demokratike çdo gjë në vlerësimin e figurës së Prof. Turdiut dhe të rolit të tij në një etapë të rëndësishme të progresit arsimor, do të rivihej në vendin që i takonte. Në vitin 1992, me propozim të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, që pati edhe mbështetjen e njëzëshme të instancave përkatëse, Presidenti i Republikës i dha titullin e lartë Mësues i Popullit. Këshilli Bashkiak i Tiranës më 1999 vendosi që shkolla e re 8-vjeçare (sot 9-vjeçare) në rrugën Don Bosko të mbante emrin e tij.

Ndihmesa e Prof. Turdiut për shkollën shqipe është dhe do të mbetet një pjesë e vyer e trashëgimisë dhe e traditës së arsimit kombëtar, për të cilën brezat do të jenë të interesuar ta njohin në thelbin e vet dhe ta përdorin racionalisht si një pjesë e përpjekjeve për përparim e standarde më të larta. Veprimtaria intensive dhe e frytshme e Prof. Qazim Turdiut përcjell edhe një mesazh të madh: ngritja në lartësinë e misionit shoqëror të mësuesit kërkon jo vetëm zotësi e përgatitje, por edhe përkushtim, korrektesë, ndershmëri, të cilat i shfaqti në shkallën më të lartë Profesori ynë, i cili ngriti në art mjeshtërinë pedagogjike.